

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, bazuar në nenin 28 dhe nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18) dhe 208/24, duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Mejnstrim Teknologji Informatike d.o.o., me seli në rrugën Brnçiçeva 49A, 1231 Lubjanë, Slloveni, Z. Aleksej Kranjec, shtetas i Sllovenisë, dhe Z. Robert Puh, shtetas i Sllovenisë, dorëzuar përmes avokates Lupka Noveska Andonova nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 18.10.2024, mori këtë

AKTVENDIM

VËRTETOHET se përqendrimi me të cilin Mejnstrim Teknologji Informatike d.o.o., me seli në rrugën Brnçiçeva 49A, 1231 Lubjanë, Slloveni, Z. Aleksej Kranjec, shtetas i Sllovenisë, dhe Z. Robert Puh, shtetas i Sllovenisë, synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë HC Center d.o.o. me seli në rrugën Letalishka cesta 32B, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes blerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve **dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit për përqendrim detyrohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimin në shumë prej 6,000.00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e shtyn zbatimin e aktvendimit.

ARSYETIM

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, më 19.09.2024, dhe plotësuar më 24.09.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) i është dorëzuar një njoftim për përqendrim nga Mejnstrim Teknologji Informatike d.o.o., me seli në rrugën Brnçiçeva 49A, 1231 Lubjanë, Slloveni, Z. Aleksej Kranjec, shtetas i Sllovenisë, dhe Z. Robert Puh, shtetas i Sllovenisë, me të cilin Mejnstrim Teknologji Informatike d.o.o., Z. Aleksej Kranjec dhe Z. Robert Puh, synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë HC Center d.o.o. me seli në rrugën Letalishka cesta 32B, 1000 Lubjanë, Slloveni, përmes blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe bazuar në të dhënat e dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Mejstrim Teknologji Informatike d.o.o. është në pronësi përfundimtare të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimi ndërkombëtar me seli në Londër. Fondet BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshira në menaxhimin e përditshëm të kompanive në të cilat investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners ka prezencë të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura indirekte të mëposhtme:

- TOTAL TV SHPK Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 17, 1-001/ Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete të shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike përmes platformave teknike DTH,
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Kosta Veselinov nr. 5-1 lokali 2/ Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete marketingu, përkatësisht me blerjen dhe shitjen e hapësirës reklamuese në mediat e shkruara dhe elektronike, dhe
- UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Partizanski Odredi nr. 14, Shkup - Qendër, Maqedonia e Veriut, e cila merret me aktivitete të telekomunikacionit satelitor.

Z. Aleksej Kranjec dhe Z. Robert Puh janë shtetas të Republikës së Sllovenisë të cilët para zbatimit të Transaksionit të Propozuar kanë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë e Synuar HC Center.

Z. Aleksej Kranjec dhe Z. Robert Puh nuk zotërojnë shoqëri në Maqedoninë e Veriut dhe nuk kanë realizuar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut.

Shoqëria e Synuar HC Center është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në vitin 2001 në Lubjanë.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë së Synuar është integrimi i sistemeve IT, përkatësisht ofrimi i shërbimeve IT, si shërbime të lidhura me serverë dhe sisteme memorie, shërbime të lidhura me qendra të të dhënave, mirëmbajtje të serverit të postës elektronike, zgjidhje për backup të të dhënave, si dhe siguri IT e të ngjashme. Përveç kësaj, Shoqëria e Synuar ofron shërbime të web hosting dhe cloud (nën markën HC Cloud).

Shoqëria e Synuar nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në vitin e kaluar ka realizuar të ardhura të parëndësishme në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës,*

vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска